



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. 2013/1 prot.

Përmet më 23.06.2026

Lënda: Kthim Përgjigje.

Në përgjigje të shkresës tuaj datë 09.06.2026, protokolluar me tonën me Nr.2013 prot, datë 09.06.2026 , bazuar në Ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" dhe Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ju informojmë se:

Për periudhën Janar -Dhjetor buxheti i planifikuar për rininë është 1 000 000 lekë. Bashkia Përmet hap thirrje duke ftuar të gjitha Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) në Shqipëri që të paraqesin projekt-propozime që janë në përputhje me objektivat zhvillimor dhe prioritetet e Bashkisë që synojnë angazhimin aktiv të të rinjve në jetën publike dhe sociale, nxitjen e pjesëmarrjes së tyre në aktivitete kulturore, sociale, mjedisore dhe komunitare, fuqizimin e rolit të tyre në proceset vendimmarrëse, promovimin e vullnetarizmit dhe inovacionit rinor, si dhe krijimin e hapësirave dhe rrjeteve rinore gjithëpërfshirëse.

Bashkia Përmet ka ndërmarrë hapa konkretë për zhvillimin e politikave rinore në përputhje me Ligjin nr. 75/2019 "Për Rininë" dhe Strategjinë Kombëtare të Rinisë. Gjatë vitit 2026 është miratuar Plani Strategjik Vendor për Rininë 2026–2029, i cili përcakton prioritetet, objektivat dhe masat për fuqizimin e të rinjve të grupmoshës 15–29 vjeç. Informacion i detajuar mbi Planin Strategjik Vendor për Rininë 2026–2029 e gjeni në linkun https://bashkiapermet.gov.al/wp-content/uploads/2026/06/Plani-i-Rinise_merged_compressed.pdf

Krahas këtij dokumenti strategjik, bashkia zhvillon dhe mbështet aktivitete kulturore, sportive, edukative, sociale dhe të pjesëmarrjes qytetare për të rinjtë. Gjithashtu pjesë e buxhetit të bashkisë është çdo vit fond i dedikuar për Rininë.

Çështjet e rinisë në Bashkinë Përmet mbulohen nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit. Koordinimi i aktiviteteve dhe politikave rinore realizohet nga Specialisti i Turizmit, i cili me urdhër të brendshëm ushtron edhe funksionin e koordinatorit dhe drejtuesit të Këshillit Vendor Rinor. Nëpërmjet kësaj strukture koordinohen aktivitetet rinore, organizohen

konsultime me të rinjtë, mbështetet funksionimi i strukturave rinore dhe monitorohet zbatimi i Planit Strategjik Vendor për Rininë.

Bashkia Përmet ka ngritur dhe mbështet funksionimin e Këshillit Vendor Rinor dhe Qendrës Rinore "Ollga Shuraja", të cilat përbëjnë mekanizmat kryesorë të përfshirjes së të rinjve në jetën publike dhe komunitare.

Për ngritjen dhe funksionimin e këtyre strukturave, Bashkia Përmet ka bashkëpunuar me institucione arsimore, organizata të shoqërisë civile dhe partnerë zhvillimorë. Një kontribut i rëndësishëm është dhënë nëpërmjet projektit EU4 Municipalities, i cili mundësoi rikonstruksionin e ambienteve të Qendrës Rinore "Ollga Shuraja". Ky bashkëpunim ka qenë i rëndësishëm për ngritjen dhe funksionimin e Këshillit Vendor Rinor dhe Qendrës Rinore, si dhe për hartimin dhe konsultimin e Planit Strategjik Vendor për Rininë 2026–2029.

Këshilli Vendor Rinor është rikonfirmuar në muajin nëntor të vitit 2025 pas përfundimit të mandatit të mëparshëm. Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar nëntë mbledhje dhe janë organizuar pesëmbëdhjetë aktivitete me pjesëmarrjen aktive të të rinjve. Aktualisht, këshilli përbëhet nga gjashtë anëtarë, ndërsa në aktivitetet dhe proceset e tij janë përfshirë dhjetë të rinj, të gjithë vajza.

Për të ushtruar në mënyrë më efektive rolin e tij, Këshilli Vendor Rinor ka nevojë për mbështetje të mtejshme në drejtim të forcimit të kapaciteteve të anëtarëve, pjesëmarrjes në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, shkëmbimit të përvojave me këshilla rinorë të bashkive të tjera dhe zgjerimit të bashkëpunimit me institucionet arsimore, organizatat rinore dhe partnerët zhvillimorë.

Përmes programit ReLOaD dhe skemave të tjera të financimit, Bashkia Përmet mbështet organizatat që punojnë me të rinjtë, duke orientuar financimin drejt nismave që promovojnë pjesëmarrjen qytetare, vullnetarizmin dhe zhvillimin e komunitetit. Prioritetet e financimit përcaktohen përmes konsultimeve me të rinjtë dhe Këshillin Vendor Rinor, përpara miratimit të buxhetit vjetor të bashkisë.

Gjatë vitit 2025, Bashkia Përmet ka organizuar dhe mbështetur një sërë aktivitete rinore dhe jo vetëm, me karakter social, kulturor, edukativ, sportiv dhe komunitar, me synim rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën publike dhe fuqizimin e rolit të tyre në komunitet. Aktivitetet janë zhvilluar në bashkëpunim me Këshillin Vendor Rinor, institucionet arsimore, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerë të tjerë lokalë. Informacion i detajuar mbi aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2025 mund të gjendet në faqen zyrtare të Bashkisë Përmet, në rubrikën e aktiviteteve: <https://bashkiapermet.gov.al/aktivitete-2025/>

Pjesëmarrja e të rinjve në proceset vendimmarrëse realizohet përmes konsultimeve publike, takimeve tematike, aktiviteteve komunitare dhe proceseve të hartimit të dokumenteve strategjike. Një shembull konkret i pjesëmarrjes së të rinjve ishte procesi i hartimit të Planit Strategjik Vendor për Rininë 2026–2029, gjatë të cilit u organizuan konsultime me Këshillin Vendor Rinor, të rinj të komunitetit dhe aktorë të tjerë lokalë. Për më shumë informacion publikimi i konsultimeve për vitin 2025 <https://bashkiapermet.gov.al/konsultimi-publik-2025/>

Sfidat kryesore që hasen në angazhimin e të rinjve lidhen me emigracionin, pjesëmarrjen jo të vazhdueshme në aktivitetet rinore, nevojën për më shumë financim për formime profesionale dhe shkëmbime përvojash, si dhe numrin e kufizuar të organizatave rinore aktive. Për të adresuar këto sfida, Bashkia Përmet përdor platforma dhe mjete të ndryshme digjitale dhe komunikimi

Sheshi "Abdyl Frashëri"; tel. +35581322254; e-mail: info@bashkiapermet.gov.al; web: www.bashkiapermet.gov.al

publik, përfshirë faqen zyrtare të internetit, rrjetet sociale, postën elektronike institucionale dhe njoftimet publike.

Në aspektin social, gjatë vitit 2025 numri total i përfituesve të Skemës së Ndihmës Ekonomike ka qenë 154 persona, nga të cilët 81 meshkuj dhe 73 femra. Nga këta, 62 kanë qenë të rinj të grupmoshës 15–29 vjeç, prej të cilëve 34 meshkuj dhe 28 femra. Numri total i përfituesve të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar ka qenë 190 persona, nga të cilët 113 meshkuj dhe 77 femra. Nga kjo kategori, 37 kanë qenë të rinj të grupmoshës 15–29 vjeç, prej të cilëve 22 meshkuj dhe 15 femra. Numri total i personave përfitues të shërbimeve të kujdesit shoqëror ka qenë 34 persona, nga të cilët 24 meshkuj dhe 10 femra.

Faleminderit për bashkëpunimin!

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA

Në mungesë dhe me porosi
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Denisa DUKRO

